



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit (Glogoc)
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 020.36508 dt. 22 07 2023

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Nenit 11, paragrafi 2, të Ligjit nr. 06/l-092 *Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës*, nenit 72 paragrafi 72.1 pika g, h, i dhe paragrafi 72.2 pika a, g, të Statutit të Komunës së Drenasit të datës 16.09.2008, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrje, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë: 27.7.2023, miratoi këtë:

VENDIM

Për krijimin e komisionit i cili do të ndihmojë dhe rekomandojë kryetarit të komunës në lidhje vlerësimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim

Neni I

Kuvendi i Komunës së Drenasit miraton vendimin për krijimin e Komisionit i cili do të vlerësojë dhe rekomandojë kryetarit të komunës në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të pranuar për dhënie të pronave me negocim.

Neni II

Komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit ka në përbërje një anëtar nga Ekzekutivi, nga të gjitha subjektet e përfaqësuara në Kuvendin Komunal të Drenasit dhe një anëtar nga shoqëria civile:

1. Arben Shala- anëtar i komisionit nga Ekzekutivi
2. Bekim Lestrani nga PDK
3. Albulena Saluku nga PDK
4. Hamit Haxhiu nga DD
5. Florenatina Elezi nga LVV
6. Egzon Qorri nga LDK
7. Beqir Kiqina nga AAK
8. Arbër Halilaj nga Green
9. Kadire Tahiraj nga Shoqëria Civile

Neni III

Me këtë vendim komisioni që të bëjë shqyrtimin e kërkesave për dhënie të pronave me negocim dhe harton raportin me rekomandim të cilin ia përcjell kryetarit, e të cilin kryetari ia sjell kuvendit për aprovim.

Neni IV

Komisioni ka mandat deri në një vendim tjetër.

Neni V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatesë;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetim

Me qëllim që procesi të shkojë sa më mirë dhe me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrje Kryetari i Komunës së Drenasit ka vendosur që të paraqesë një propozim vendim për krijimin e një komisioni përmes të cilit të gjitha subjektet e përfaqësuara në kuvend do të kenë mundësi të jenë të informuar në detaje në lidhje me procesin e negocimit.